



GJIMNAZI "NAIM FRASHËRI" SHTIME

Adresa: Rruga "Isa Boletini", nr. 92, 72000 Shtime
Tel. 0290/390-564

Nr. i Protokollit: 156/22

Datë: 13.05.2022

Duke u bazuar në Vendimin e Këshillit Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më 12 maj 2022

GJIMNAZI "NAIM FRASHËRI" NË SHTIME shpall:

OFERTË PËR EKSKURSION



Gjimnazi "Naim Frashëri" në Shtime, bënë organizimin e Ekskursionit të Maturantëve për në Shqipëri prej datës 18. 05. 2022 deri më 19. 05. 2022 sipas Udhëzimit Administrativ për Aktivitetet Jashtëshkollore, nr. 02/2016, neni 11, të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT).

Ekskursioni gjatë qëndrimit dyditor (2) në Shqipëri do të bëhet sipas relacioneve në qytetet:

- Më 18 maj 2022, ora 7:00 nga Shtimja bëhet nisja për Durrës.
 - Vendosja në Hotel dhe sistemimi nëpër dhoma gjumi. Dhomat të pajisura me jo më shumë se tre shtretër. Secila dhomë të ketë banjon e vet me ujë të ngrohtë gjatë gjithë kohës. Mbulesa të pastërta dhe të mjaftueshme.
 - Dreka: 13:00-14:00. Sasia e udhqimit dhe e bukës të jetë e freskët dhe e mjaftueshme për secilin nxënës. Ushqimi të jetë kualitativ dhe kalorik.
 - Më 18 maj 2022, vizitë qytetit në Lezhë (te varri i Skënderbeut) – Shkodër. duke vazhduar me qytetin e vjetër të Durrësit dhe amfiteatrit antik; Pagesa për hyrjen e nxënësve në amfiteatër bëhet nga kompania kontraktuese.
 - Darka: 19:00-20:30. Sasia e udhqimit dhe e bukës të jetë e freskët dhe e mjaftueshme për secilin nxënës. Ushqimi të jetë kualitativ dhe kalorik.
 - Muzikë: 21:00-00:00. Muzikë live ose DJ sipas dëshirës së nxënësve. Mbrëmja mbaron në ora 23:00.
- Më 19 maj 2022
 - Mëngjesi në ora 07:00-08:30. Sipas menysë e cila rëndomtë shtrohet në mëngjes: Ushqim, pije të ngrohta dhe sasi e mjaftueshme e bukës.
 - Vizitë kryeqytetit shqiptar – Tiranës. Nisja në ora 10:00.
 - Vizitë në qytetin e Krujës, përkatësisht në Muzeun Kombëtar "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu" Pagesa për hyrje bëhen nga kompania kontraktuese.
 - Dreka: 13:00-14:00. Sasia e udhqimit dhe e bukës të jetë e freskët dhe e mjaftueshme për secilin nxënës. Ushqimi të jetë kualitativ dhe kalorik.
 - Darka: 19:00-20:30. Sasia e udhqimit dhe e bukës të jetë e freskët dhe e mjaftueshme për secilin nxënës. Ushqimi të jetë kualitativ dhe kalorik.

Kthimi për në Kosovë në ora 14:00.

Bartja e nxënësve (afërsisht 203) bëhet me autobusë nga agjenci turistike sipas relacioneve të lartpërmendura, ndërsa akomodimi dhe qëndrimi bëhet në hotel (Durrës). Akomodimi gjatë qëndrimit përfshin: fjetjen, sigurinë fizike dhe shëndetësore (24 orëshe). Ushqimin cilësor, kalorik dhe i bollshëm.

Ndërkohë, Agjencioni duhet t'i përmbahet të gjitha obligimeve që dalin nga UA 02/2016.

Hotelit duhet të jetë i përshtatshëm. Me jo shumë kate. Nëse ka më shumë se tri kate të posedojë ashensor. Staf i Hotelit duhet të sigurojë pastërti të ambientit ku rrijnë dhe argëtohen nxënësit. Hoteli duhet të sigurojë po ashtu çmime të njëjta të produkteve të tjera (pos atyre që janë në kontratë) me të njëjta çmime që janë edhe jashtë hotelit.

Në këtë ofertë mund të konkurojnë të gjitha agjencitë, të cilat i plotësojnë këto parakushte:

- Të kenë licencën sipas Ligjit mbi Transportin,
- Të kenë bërë dëshmi mbi kontrollin teknik sipas procedurave ligjore dhe teknike,
- Të kenë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevoja të shkolës,

- Autobusët të jenë komfort dhe me kondicioner,
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin psiko-fizik të ngasësëve,
- Agjencioni duhet t'i ketë fotokopje librezat e autobusëve,
- Të përkrahë nxënësit me shërbime mjekësore si dhe dëshminë e certifikatës së punës së mjekut,
- Agjencioni duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve,
- Në bashkëpunim me hotelin e mundshëm, nxënësve dhe personelit përcjellës, t'iu ofrohet siguria 24 orëshe.
- Kolona e autobusëve të jetë e harmonizuar dhe të mos ketë ndarje (lëvizje e autobusëve një pas një).
- Itinerari të respektohet në mënyrë strikte, ndërsa ndryshimet eventuale mund t'i bëjë në marrëveshje të plotë me drejtorët e shkollave.

Pas shqyrtimit të ofertave nga ana e komisionit i përbërë nga DKA dhe SHML "Naim Frashëri", do të përzgjedhet oferta më e favorshme dhe me plotësim të kushteve sipas Ligjit. Dokumentacioni për aplikim dorëzohet në DKA në ndërtesën e Komunës së Shtimes (Kati III).

Afati i paraqitjes me të gjitha dëshmitë dhe dokumentacionin është pesë (5) ditë nga dita e publikimit në tabelën e njoftimeve në shkollë dhe web-faqe zyrtare të Komunës së Shtimes (kk.rks-gov.net/shtime/) sipas kuotimit të çmimit nën vlerën 10.000€.

Ofertat do të hapen pas skadimit të afatit për ofertim (e marte), më 17 maj 2022, ora 12:00. Ofërtuesi i përzgjedhur nga komisioni i merr të gjitha obligimet sipas UA nr. 02/2016, përkatësisht neni 11. Përzgjedhja e ofertuesit do të bëhet në ora 16:00.

Drejtori,
Zejnepe HYSENAJ

